

**VENDIM**  
**Nr. 404, datë 16.7.2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË  
VLERËSUAR TË VITIT 2023 PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2023, me indeksin 9.3%, të llogaritur sipas kritereve, të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për llogaritjen e bazës së vlerësuar individuale vjetore, të arritur nëpërmjet kontributeve të paguara dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2023, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.1.2025 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritura nëpërmjet pagave të periudhës 1994-2023, referuar kontributeve të paguara sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese sipas punëve dhe profesioneve, e përcaktuar me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2023, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë fillimi nga data 1.1.2025, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për pagat e periudhës, nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar sipas kritereve të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve dhe aplikohen vetëm për pensionet me datë fillimi nga data 1.1.2025 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2025.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**SHTOJCA NR. 1**

| <b>Tabela e koeficientëve akumulative të indeksimit të bazës së vlerësuar</b> |        |
|-------------------------------------------------------------------------------|--------|
| Për pagat referuese deri në datën 31.12.1993                                  | 13.397 |
| Për pagat e vitit 1994                                                        | 13.397 |
| Për pagat e vitit 1995                                                        | 10.781 |
| Për pagat e vitit 1996                                                        | 8.365  |
| Për pagat e vitit 1997                                                        | 8.365  |
| Për pagat e vitit 1998                                                        | 6.990  |
| Për pagat e vitit 1999                                                        | 5.673  |

|                        |       |
|------------------------|-------|
| Për pagat e vitit 2000 | 5.167 |
| Për pagat e vitit 2001 | 4.420 |
| Për pagat e vitit 2002 | 4.082 |
| Për pagat e vitit 2003 | 3.654 |
| Për pagat e vitit 2004 | 3.319 |
| Për pagat e vitit 2005 | 3.014 |
| Për pagat e vitit 2006 | 2.737 |
| Për pagat e vitit 2007 | 2.616 |
| Për pagat e vitit 2008 | 2.310 |
| Për pagat e vitit 2009 | 2.125 |
| Për pagat e vitit 2010 | 2.034 |
| Për pagat e vitit 2011 | 1.958 |
| Për pagat e vitit 2012 | 1.883 |
| Për pagat e vitit 2013 | 1.805 |
| Për pagat e vitit 2014 | 1.805 |
| Për pagat e vitit 2015 | 1.560 |
| Për pagat e vitit 2016 | 1.560 |
| Për pagat e vitit 2017 | 1.529 |
| Për pagat e vitit 2018 | 1.476 |
| Për pagat e vitit 2019 | 1.441 |
| Për pagat e vitit 2020 | 1.400 |
| Për pagat e vitit 2021 | 1.351 |
| Për pagat e vitit 2022 | 1.241 |
| Për pagat e vitit 2023 | 1.093 |
| Për pagat e vitit 2024 | 1.000 |
| Për pagat e vitit 2025 | 1.000 |